

Npi – 01/188 datë: 31.08.2020

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.11 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/149 të datës: 31.05.2019, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më: 31.08.2020 është nxjerrë ky:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I M B L E D H J E S Ë - V I - T Ë R R E G U L L T T Ë K U V E N D I T T Ë K O M U N Ë S S Ë S H T I M E S

E mbajtur më: 31.08.2020, e (hënë) në ora 10.^{oo} h. në sallën e Kuvendit Nr.1

Në mbledhje kanë marrë pjesë: znj.Medina Brahaj, z.Perparim Ramusa, z.Herolind Selmani, z.Reshat Mujota, znj.Arbresha Syla, z.Milot Deliu, znj.Fatmire Ferati, z.Naim Zejna, z.Skender Hyseni, znj.Zarife Rexhaj, znj.Valentina Halili-Ferati, z.Ruzhdi Jashari, z.Besnik Seferi, znj.Marigona Pajaziti, z.Fehmi Hysenaj, znj.Adelina Beqaj, z.Isak Muslija, znj.Diarta Vishesella, z.Muhamet Ademaj, dhe z.Rexhep Gashi.

Përveç anëtarëve të Kuvendit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Nënkryetari, z.Rrahman Jakupi; Zyrtarja Kryesore Financiare znj.Kimete Ukaj; Zyrtari i Auditimit të Brendshëm z.Jetush Rrafshi; Zyrtari për Informim z.Lulzim Sahiti; Zyrtari i IT-së Gazmend Ademaj.

Mbledhjen e hapi Kryesuesja e Kuvendit znj.Medina Brahaj, e cila pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit Konstatoj, Kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar mbledhjen. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesver. të Kuvendit më:14.05.2020, 10.06.2020, 30.06.2020, 09.07.2020,
2. Pyetje-Përgjigje,
3. **Draft-Buxheti per periudhën 2021-2023, (Është larguar nga rendi i ditës)**
4. Shqyrtimi i Raportit buxhetor për periudhën Janar – Qershor 2020,
5. Draft-Rregullore Komunale për mbrojtjen e Fëmijës (pas diskutimit publik),
6. Informatë mbi Raportin e performancës së Komunës,
7. Informatë mbi Raportin e Auditorit të Brendshëm për vitin 2019,
8. Informatë mbi Raportin e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2019,
9. Shqyrtimi i Kërkesave.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Para se të hapë diskutimin për rendin e ditës, propozoj që pika e 3 e rendit të ditës “Draft-Buxheti per periudhën 2021-2023” të shtyhet me arsyetimin se kemi marrë Rekomandim nga Ministria e Financave, që të shtyhet. Në vazhdim hapi diskutimin për rendin e ditës të propozuar.

*** Kuvendi i Komunës, me 15 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim” aprovoi Rendin e Ditës pa pikën 3 “Draft-Buxheti per periudhën 2021-2023”.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesver. të Kuvendit më:14.05.2020, 10.06.2020, 30.06.2020, 09.07.2020

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Ruzhdi Jashari; Përshëndetje për të gjithë. Katër Procesverbale na vijnë për një herë, sekretarin e Kuvendit e keni shëndrruar në procesmbajtës, në vend që të merret me punët profesionale të Kuvendit, siq janë vendimet, rregulloret etj. Ka mundësi të merrni edhe zyrtar me kontratë në vepër sikurse që e keni bërë për raste tjera. Kjo çka po bëni është pa përgjegjësi dhe është e pa falshme, që disa herë që e ngrisin në Kuvend këtë çështje, e nga ekzekutivi po kalon në heshtje, e ne kështu po lejojmë të shkojë. Si ka mundësi që katër procesverbale ti shqyrtojmë për një herë.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; E dimë të gjithë situatën që e kemi pas me pandeminë në këtë periudhë, kështu që edhe plani i mbajtjes së mbledhjeve ka ndryshuar tërësisht. Ndeshi me kuptuar mirë nëse jo është puna juaj.

z.Perparim Ramusa; Përshëndetje, unë jam për me kaluar këto Ekstrakte të Procesverbaleve. mendoj se secili e mbanë mend se çka ka diskutuar.

z.Fehmi Hysenaj; Përshëndetje, për mua është e arsyeshme me 4 procesverbale, por kërkoj që mos të përsëritet kjo dhe mos të jetë më shumë se dy procesverbale, por normal që duhet me ardhur nga një procesverbal. Disa fjalë po ndryshohen por nuk ka rëndësi sepse përmbajtja është mirë.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 17 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, me 16 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim” aprovoi, Ekstrakt Procesverbalet e Kuvendit më:14.05.2020, 10.06.2020, 30.06.2020, 09.07.2020.**

Pika 2

Pyetje-Përgjigje

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Fehmi Hysenaj; Përgjigjet që po na vijnë nga Ekzekutivi nuk janë të plota. Në pyetjen time, se asfalti në rrugën për Llanisht nuk është në rregull, përgjigja është nga DPUKGJ-ja se është në rregull.

Tash unë duhet me kërkuar tjetërkund se a është mirë asfalti. Te trotuari kanë thënë se ka rrëshqitur në lum sepse nuk kemi bërë mur mbrojtës. Pyetjet për këtë mbledhje i kam dërguar me E-mail:

1. Ish Stacioni Policor në Shtime në rrugën “Anton Çeta” që nga koha e largimit i policisë ky objekt dhe oborri i tij kanë mbetur pa asnjë përkujdesje. Sipas informatave oborri është bërë strehë e qenve endacak, por nga rritja e barit dhe pemëve janë krijuar edhe ca zvarranikë që mund të jenë trishtues për nxënësit që aty afër kanë për ta filluar mësimin. Ndërsa pemët që vazhdimisht po rriten tanimë kanë bllokuar një pjesë të trotuarit dhe njerëzit lëvizin në asfalt ku qarkullojnë veturat?

2. Edhe për pengesat (policët e shtrirë) në rrugën e Petrovës ishin shumë të papërshtatshme?

3. Kur përfundojnë punimet në zgjerimin e rrugës “Ahmet Shtimja” se është bërë pengesë për sigurinë e lëvizjes?

z.Ruzhdi Jashari; Kam pyetur për dhënien e lejes për qebaptoren në oborrin e shkollës fillore “Emin Duraku” në Shtime, kemi marrë përgjigje kontradiktore, njëra drejtori thotë ndryshe, e tjetra thotë po kemi dhënë leje por jo për ndërtim të fortë. Kjo është pasqyra e udhëheqjes së Komunës. Me insistimin e opozitës kemi marrë vendim si Kuvend që të gjitha objektet rreth shkollës të hiqen, pse objekti i qebaptores nuk është hjekë?

z.Naim Zejna; Përshëndetje, më herët e kam bërë një kërkesë te DSHP-ja dhe e kam marrë një përgjigje se kanë me u vendosur dy pasqyre te komunikacionit. 1. Kur do ti vendos DSHP-ja Pasqyrat që ka thënë se do ti vendosë? 2. A do të vendosen barrierat “policët e shtrirë” në rrugën “Jetë Hasani”? 3. Pse këto ditë po ndalet uji i pijes shumë shpesh?

z.Rexhep Gashi; Edhe unë kam për afërsisht të njëjtin shqetësim lidhur me dhënien e përgjigjeve të mangëta që po na vijnë nga ekzekutivi në pyetjet tona. Pse Ekzekutivi i Komunës nuk i jep përgjigjet e plota? Unë kam bërë pyetje për asfaltimin e rrugës deri te shpella e Pjetërshticës, pastaj kam pyetur edhe për Antenat, kam pyetur edhe për anëtarët e Komisionit për vlerësimin e parcelave se a kanë licencë e që nuk kam marrë përgjigje.

z.Muhamet Ademaj; Përshëndetje, unë kam këto pyetje: 1. Pyetje për DPUKGJ-në, kur do të filloj kanalizimi në lagjen Ademaj? 2. Pyetje për DZHE-në, sa është numri i bizneseve të reja gjatë vitit 2020? 3. Pyetje për DSHP-në, sa është furnizimi me ujë për pije në komunën e Shtimes?

z.Besnik Seferi; Përshëndetje, fillimisht dua të ju njoftoj se lidhur me përhapjen e një vale të Mushkonjave ka pas reagime të shumta në rrjetet sociale si psh. në F.B. në ueb-faqen e Komunës se çka do të ndërmarr Komuna lidhur me Mushkonjat e përhapura gjithandej. Prandaj pyetja ime është kështu: 1. A e ka në plan Komuna me ndërmarrë diçka për eliminimin e mushkonjave? Unë kam pas rastin me biseduar me taksistët për Ferizaj, ata më kanë thënë se e kanë problem vendqëndrimin e tyre sepse me rregullimin e parkut është mbyllur edhe vendprirja e tyre, ata po kërkojnë një vendprirje aty. 2. A ka mundësi që tu sigurohet një vendprirje për taksistët te hyrja e parkut “Ahmet Shtimja”? Edhe e fundit, 3. Kërkoj që të qiten barrierat “policët e shtrirë” te udhëkryqi i rrugëve “Anton Çeta” dhe rruga “Transit”.

z.Skender Hyseni; Përshëndetje, edhe unë e përkrahu dhe është mirë për kërkesën sa i përket Mushkonjave. Unë kam një kërkesë tjetër që ka të bëjë me vazhdimin e rregullimit të rrugëve të arave sepse kanë mbetur në gjysmë, dhe bujqit po kanë problem shumë të madh për me hy në arat e tyre me marrë bereqetin. Kështu që unë kam këtë pyetje: 1. A ka buxhet që të vazhdohet me rregullimin e rrugëve të arave që kanë mbetur në gjysmë?

znj.Adelina Beqaj; Përshëndetje, meqenëse jemi në prag të fillimit të vitit të ri shkollor, për Drejtorinë e Arsimit, kërkoj një Informatë lidhur me përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor. Dhe e dyta kërkoj që Drejtoria për Shërbime Publike të ndërmarrë masa që barrierat në rrugën e Petrovës të rregullohen sepse janë shumë të larta.

Pika 3

Shqyrtimi i Raportit buxhetor për periudhën Janar – Qershor 2020

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Kimete Ukaj.

znj.Kimete Ukaj, zyrtare kryesore financiare; Pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit tha: Raporti buxhetor është pjesë e obligimeve që i kemi për ta prezantuar në Kuvend. Raporti është përgatitur sipas standardeve dhe afateve ligjore. Meqenëse Raportin e kemi dërguar te ju me kohë në formë të shkruar unë besoj se e keni përpunuar,(shih dokumentin). Në vazhdim prezantoi raportin me shifra duke lexuar tabelat sipas kodeve buxhetore, dhe kategorive ekonomike. Ne i mirëpresim pyetjet.

znj.Adelina Beqaj; Unë kam një pyetje për zyrtaren e financave, disa prej kategorive ekonomike nuk kanë shpenzime fare, a do të thotë se ka ndikuar pandemia KOVID19, te këto apo është në pyetje diçka tjetër?

z.Ruzhdi Jashari; Ne kemi vërejtje direkt te ndarja e 100.000€ për pandeminë, në Kuvend. Ka pas një deklaratë të qartë nga Kryetari se do të raportoj në Kuvend pik për pikë për shpenzimin e tyre, dhe se nuk kemi një raport të tillë. Nuk kemi një raport specifik në mënyrë analitike për shpenzimin e mjeteve financiare që kanë qenë të dedikuara ekskluzivisht për pandeminë KOVID19.

z.Fehmi Hysenaj; Unë kam disa vërejtje në këtë raport, është për të ardhur keq për performancën me shifra të tilla të ultë, psh. sa u përket Komunalive, Subvencioneve etj. pse mos me i shpenzuar

mjetet e ndara buxhetore, kjo është shenjë e keq menaxhimit. Zyrtarët Komunal duhet të bëjnë punën e tyre, edhe përkundër faktit që dihet se kemi pas pandeminë KOVID19. Zyrtarja kryesore financiare tha se kemi 68% ndërkaq që unë kur i llogarita më doli 62% po pyes ku është problemi?

z.Naim Zejna; Është e arsyeshme, por ndoshta vetëm nga muaji Mars e këndej kur kemi pas kohën e pandemisë, prandaj edhe kriteret për të kërkuar përgjegjësi duhet të jenë më të matura. Te shpenzimet e kemi problem me 34%. Përveç pagave, te shpenzimet tjera janë minimale. Unë nuk jam i kënaqur me shpenzimet që janë bërë për 6 mujorin e parë, e jo sa i përket të hyrave.

znj.Arbresha Syla; Përshëndetje, unë nuk desha ta marr fjalën për faktin, se nuk jam profesioniste në këtë fushë, por duke e dëgjuar opozitën, që po i bënë pyetjet e njëjta dhe po përsëriten gjithnjë, me siguri për populizëm, e kur dihet se ne e kemi pas dhe e kemi një pandemi që duhet ti përqendrojmë forcat për parandalimin e sajë. Pastaj tjetra kur opozita nuk janë të kënaqur me shpenzimet e jo me faktin se janë të hyrat e ultë, deri sa për mua pandemia ka qenë e njëjtë edhe për ata që është dashur me paguar tatimin. Komuna jonë është munduar që ta realizojë buxhetin sa më mirë edhe në këtë kohë të pandemisë, kështu që janë bërë edhe punë të mira që po i shohin qytetarët, këto kanë qenë punë nga projektet që ne vetë i kemi aprovuar në Kuvend.

z.Muhamet Ademaj; Faleminderit për raportin. Raporti është përgatitur mirë. Të hyrat janë të vogla por është edhe e kuptueshme në këtë kohë të pandemisë. Unë besoj se do të përmirësohet në 34-38%.

z.Rexhep Gashi; Përshëndetje për zyrtaren financiare, ne nga përvoja që e kemi nga e kaluara, nuk mendojmë se është problem te të hyrat vetanake por pikërisht te shpenzimet. Ne i kemi ndarë 100.000€ për sa i përket pandemisë KOVID19, tash ne e kemi vetëm një raport nga QKMF-ja në bazë të cilit ne e dimë se në QKMF-ë janë ndarë vetëm 16.000€, për të tjerat mjete ne nuk dimë fare se ku kanë shkuar. Unë kam një pyetje për zyrtaren financiare, se pse është hequr nga lista e projekteve nga grandet qeveritare, asfaltimi i rrugës deri te shpella e Pjetërshticës?

z.Reshat Mujota; Përshëndetje, unë desha ta bej një pyetje lidhur me menaxhimin e parkingjeve publike në rrugën kryesore, pse tani parkingjet kanë mbetur pa i menaxhuar askush, as KRM “pastërtia” që ja kemi dhënë me vendim të Kuvendit, e as Shoqatat që e kanë pas më herët?

znj.Fatmire Ferati; Përshëndetje, raporti është përgatitur mirë, mirëpo siç e dini edhe buxheti i Kosovës është aprovuar me vonesë me sa e di Janar ose Shkurt. Pastaj kur është fjala për ndarjen e subvencioneve në fushën e sportit, duhet të respektohen procedurat, duhet të bëhet përmes shpalljes me thirrje publike, e që të gjitha këto marrin kohë bukur të gjatë, dhe krejt kësaj kur ja shtojmë edhe faktin se kemi një pandemi me të cilën të gjithë po duhet të ballafaqohemi.

znj.Kimete Ukaj, zyrtare kryesore financiare; Të gjithë e kemi të qartë se gjendemi në pandemi KOVID19 që ka përparësi në krahasim me fushat tjera, prandaj jo gjithçka ka shkuar dhe është varur nga vullneti ynë. Nga këto 100.000€ që i ka ndarë Kuvendi, Janë Alokuar 40.000€ për Administratë, pastaj 20.000€ në Arsim, dhe 20.000€ në Shëndetësi etj. por kjo pjesë nuk është shpenzuar ende. Nga dhjetë milionëshi i Qeverisë së Republikës së Kosovës i premtuar për Komuna, ne nuk kemi marrë asnjë cent. Taksa e parkingut nuk hynë te Shërbimet Publike.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 18 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, me 13 vota “Për” me 2 vota “Kundër” dhe me 3 vota “Abstenim” aprovoi, Raportin buxhetor për periudhën Janar – Qershor 2020.**

Pika 4

Draft-Rregullore Komunale për mbrojtjen e Fëmijës (pas diskutimit publik)

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Rrahman Jakupit.

Nënkryetari, z.Rrahman Jakupi; Ne e kemi respektuar vendimin e Kuvendit për ta nxjerrë në diskutim publik këtë draft rregullore, por nuk është se kemi pas shumë rekomandime, por kjo është pak a shumë për shkak të pandemisë. Kemi një propozim për heqjen e nenit 6 që realisht rregullohet

me nenin 20 të Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve. Po ashtu është propozuar që të hiqet edhe neni 7 i draft rregullores sepse rregullohet me Ligjet përkatëse. Një rregullore të tillë për fëmijë e kanë aprovuar edhe komunat siç janë, Gjilani, Ferizaj në vitin 2019 etj.

z.Perparim Ramusa; Ne e kemi diskutuar mjaft gjatë edhe në KPF-ë dhe kemi rekomanduar që ta aprovojmë, prandaj edhe këtu në Kuvend propozoj që këtë rregullore ta aprovojmë.

z.Naim Zejna; I bashkohem propozimit, por nuk kemi pas kohë të mjaftueshme për të ju përkushtuar pak më shumë kësaj rregullore. Por sido që të jetë e përkrahim dhe do ta votojmë këtë rregullore për mbrojtjen e fëmijëve.

z.Ruzhdi Jashari; Kjo rregullore është pjesë e sistemit juridik që pretendon me e rregulluar një fushë shumë të rëndësishme siç janë fëmijët. Ne e kemi analizuar mirë dhe i kemi pa të metat, prandaj kemi propozime konkrete. Te neni 1 i rregullores, te çështjet e thirrjes së akteve ndërshtetërore, ne e kemi edhe një Kontratë Evropiane, dhe një Agjenci e Këshillit të Evropës, e cila merret ekskluzivisht me këtë çështje, mirëpo nuk po shoh që kemi asnjë referencë të sajë në këtë dokument. Prandaj unë po propozoj që të futet edhe Konventa Evropiane. Te neni 4 propozoj që të shtohet edhe pika e 13 ku do të thuhej “Të merr pjesë në ngjarje e aktivitete Rajonale” që lidhen me fëmijët. Te neni 5 pika 3.1 hierarkia nuk qëndron kështu, Kryetari i Komunës duhet të jetë pas Kuvendit. Te neni 7 me të drejtë u propozua për me u hjekë ky nen. Te neni 11 propozoj që të shtohet edhe pika 6 ku gjithashtu shkruhen fjalët “Të merr pjesë në ngjarje e aktivitete Rajonale”.

z.Fehmi Hysenaj; Materialin e kemi marrë me kohë. Zakonisht, draft dokumentet e kanë edhe autorin e që në këtë rast nuk e kemi por nuk ka gjë të keqe. Nëse kemi diçka për të ndryshuar e kemi mundësinë që ta bëjmë më lehtë. Te neni 4 pika 2.6 shkruan qartë për mbrojtjen e fëmijëve por ne jemi dëshmitarë, që kemi fëmijë nën moshën 18 vjeçare që janë duke punuar, sidomos ka fëmijë nga shteti amë që abuzohen si lëmshë kërkues. Unë e shoh si të nevojshme dhe do ta votoj këtë rregullore, mirëpo po të kishte një Komision ndoshta do ta rregullonte më mirë në disa pika.

znj.Zarife Rexhaj; Përshëndetje, sa i përket nenit 4 pika 2.4, kjo pikë unë mendoj se duhet të jetë e obliguar dhe duhet që të merren shënime esenciale.

Nënkryetari, z.Rrahman Jakupi; Dha sqarime në pyetjet e anëtarëve të Kuvendit. Kam një rekomandim që neni 6 do të hiqet në tërësi dhe do të zëvendësohet me ekipin për të drejtat e fëmijëve sipas nenit 20 dhe përkufizoi nenin 20 për ekipin e të drejtave të fëmijëve, ku thotë Ekipi për të Drejtat e Fëmijëve krijohet me këtë ligj. Ekipi ka përgjegjësi për kujdesin dhe zbatimin e rekomandimeve dhe vendimeve të nxjerrura të parapara sipas ligjit.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 20 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Kuvendi Komunës së Shtimes, unanimisht aprovoi, Rregulloren Komunale për mbrojtjen e të drejtave të Fëmijëve. Duke marrë parasysh edhe propozimet që u dhanë nga anëtarët e Kuvendit, por obligohet Zyra Ligjore që të bëjë kontrollimin e neneve të propozuara nëse janë në përputhje me ligjin.**

Pika 5

Informatë mbi Raportin e performancës së Komunës

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Jetush Rrafshi.

z.Jetush Rrafshi, Auditor i brendshëm; Pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, para Kuvendit prezantoi Informatën për performancën e Komunës. Këtë raport ne e kemi përgatitur në formë të shkruar, dhe ua kemi dërguar me kohë edhe juve që ta lexoni, por të njëjtin e kemi dërguar edhe në Ministrinë për Administrimin e Pushtetit Lokal. Ky raport është për 10% më i mirë se vitin e kaluar. Unë nuk po vazhdoj më tutje, meqenëse dokumentin e kemi marrë me kohë por i mirëpres pyetjet e juaja, (shih dokumentin).

z.Muhamet Ademaj; Faleminderit për këtë informatë. Uroj që performanca e Komunës të ngritet sepse është e mirëseardhur.

Pika 6

Informatë mbi Raportin e Auditorit të Brendshëm për vitin 2019

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Jetush Rrafshi.

z. Naim Zejna; Unë po kërkoj një pauzë prej 10 minutave.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Dha 10 minuta pauzë në ora 11⁴⁵h.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Mbledhja e Kuvendit vazhdon në ora 12⁰⁰h. fjala është për Jetush Rrafshin.

z. Jetush Rrafshi, Auditor i brendshëm; Raporti ndahet në dy pjesë: 1. Përshkrimi i gjendjes aktuale, dhe pjesa e dytë, 2. Vlerësimet e Auditorit të brendshëm. Raportin e kemi marrë të shkruar, prandaj unë po konsideroj se nuk ka nevojë që ta lexoj. Ne i mirëpresim pyetjet e juaja, (shih dokumentin).

z. Fehmi Hysenaj; Faleminderit për raportin. Ajo që shihet në këtë raport është se janë kryer disa auditime. Ndoshta më mirë është të thuhet raport sesa informatë, sepse aty janë disa rekomandime të cilat ekzekutivi duhet ti zbatojë.

z. Ruzhdi Jashari; E përshëndes punën e auditorit ku tregohet rruga se kah duhet ecur. Në këtë informatë janë marrë 14 mostra. 6 rekomandime janë të adresuara, ndërsa 8 janë të pa adresuara, e të cilat nuk kanë adresim të çështjes. Unë konsideroj se nuk është një raport i kënaqshëm, prandaj mendoj se duhet me i hap sytë mirë. Një vërejtje e tillë ekziston edhe nga Auditori Gjeneral. Për mua shqetësues është çështja e punësimeve, dhe këtu në këtë raport po shihet më së miri. Në këtë raport po mungojnë tabelat krahasuese për vitet 2017 dhe 2018. Opinioni i Auditorit duhet të shkojë kah zero. Këtu po shihet se si njerëzit janë punësuar për vota, pa pasur kurrfarë përvoja.

znj. Arbresha Sylja; Përshëndetje, një gjë duhet me ditë se opinioni i Auditorit të Jashtëm është i fundit më i miri (i pa kualifikuar). Njeriu gjatë punës mund të ketë edhe lëshime, por ato duhet të përmirësohen. Auditori na tregon se ku duhet të bëhen përmirësime. Kjo është e rëndësishme të bëhet.

z. Naim Zejna; Konsideroj se Raporti i Auditorit të Brendshëm është mjaftë i rëndësishëm, aty janë paraqitur disa raste të auditimit. Nuk është punë e Kuvendit me e marrë nën mbrojtje punën e administratës. Konsideroj se jemi duke shkuar në përmirësimin e gjendjes reale.

z. Muhamet Ademaj; Unë mendoj se Auditori i Brendshëm nuk i ka duart e lira të punojë ky është shqetësimi im. Përndryshe Raporti paraqet disa raste të Auditimit në të cilat janë dhënë edhe rekomandime të cilat duhet të zbatohen.

z. Isak Muslija; Pajtohem me disa parafolës. Ne duhet ti përkrahim ato rekomandime të cilat janë me vend. Kjo është detyra jonë. Neve na e kanë dhënë votën për ta mbrojtur në Kuvend interesin e përgjithshëm e jo të administratës ose dikujt tjetër. Këtë duhet ta dinë qytetarët e nderuar.

z. Jetush Rrafshi, Auditor i brendshëm; Raporti është paraqitur për ti plotësuar standardet ndërkombëtare të Auditimit. Neve na monitorojnë edhe njësitë Qendrore e Auditimit. Rekomandimet i kemi dhënë për gjetjet që janë bërë nga auditori. Qëllimi i auditimit është avancimi i kontrollit financiar. Është për ta vlerësuar nga aspekti i transparencës shqyrtimi i raportit që i është bërë në Kuvend.

Pika 7

Informatë mbi Raportin e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2019,

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Kimete Ukaj.

znj. Kimete Ukaj, zyrtare kryesore financiare; Është një informatë mbi raportin e Auditorit të Jashtëm i cili e ka nxjerrë në Komunën tonë. Raporti ka të bëjë me shpenzimet që janë bërë gjatë vitit 2019 (pasqyrat vjetore financiare). Ky raport bazohet në 3 shtylla: 1. Pasqyrat Vjetore Financiare, 2. Menaxhimi dhe Kontrolli Financiar, dhe 3. Zbatimi i Rekomandimeve. Në vazhdim

Kimete Ukaj elaboroi për secilën shtyllë veç e veç. Opinioni i Auditorit të Jashtëm është (i pa kualifikuar) i cili është opinioni më i mirë i dhënë. Ky opinion është nxjerrë mbi bazën e mostrave që i kanë marrë Auditorët. Ata kanë dhënë edhe 17 rekomandime, të cilat duhet të zbatohen. Unë nuk do ta zgjasë më shumë për faktin se dokumentin e kemi marrë me kohë në formë të shkruar, (shih dokumentin). I mirëpres pyetjet e juaja.

z.Naim Zejna; Unë edhe në KPF-ë kamë kërkuar që pikat 7 dhe 8 të rendit të ditës që kanë të bëjnë me raportet e Auditorit të Brendshëm dhe të Jashtëm me u trajtuar edhe në KPF-ë. Është interesantë se me gjithë këto të gjetura Auditori i Jashtëm ka dhënë opinionin më të mirë (të pa kualifikuar), gjë që këtë unë nuk e kisha bërë, sidoqoftë është puna e tyre. Ne kemi bërë vërejtje rregullisht për detyrimet kontingjente. Pastaj kemi edhe çështjen tjetër nuk janë zbatuar rekomandimet e vitit 2018. Unë nuk pajtohem me një pikë të tillë të veprimt të Auditimit. Për mua shumë më e rëndësishme është çështja e Planit të Veprimt për zbatimin rekomandimeve.

z.Fehmi Hysenaj; Faleminderit për raportin të cilin e kemi marrë me kohë, por edhe ka qenë publik në ueb-faqe. Sa i përket opinionit të Auditorit edhe unë i kam dilemat e mia, sepse opinionin (i pa kualifikuar) është ndër më të mirët. Duhet përsëritur se rekomandimet e vitit të kaluar janë adresuar. Shpenzimet për ditën e Masakrës së Reçakut rreth 7000 euro duhet me na dhënë sqarime çka u bë me to. Ka disa rekomandime që nuk kanë mundur me u zbatuar, mirëpo unë mendoj se në letrën e pranimit që e ka bërë Kryetari ka qenë mirë me e shkruar se disa prej rekomandimeve nuk mund të zbatohen.

z.Muhamet Ademaj; Faleminderit për raportin. Ky raport nuk mund të ndryshohet, të gjeturat janë reale por edhe shqetësuese. Në 10 rekomandime unë kërkoj që ato të zbatohen.

z.Fehmi Hysenaj; E harrova pa e përmendur edhe një çështje, kjo është Komiteti i Auditimit i cili vërtet nuk po funksionon edhe pse në përbërjen e tij i kemi minimumin prej 3 anëtarëve.

z.Perparim Ramusa; Përsëritet, unë desha vetëm të ja sqaroj Naim Zejnës se KPF-ja funksionon mbi bazën e rregullores e jo mbi bazën e dëshirës së individit. Informata nuk votohet ndërkaq raporti duhet të votohet. Kjo është një informatë mbi raportin e Auditorit, dhe nuk ka nevojë që të votohet.

znj.Kimete Ukaj, zyrtare kryesore financiare; Raporti i Auditorit është publikuar, dhe në të nuk ka mundësi të bëhen ndryshime. Me rekomandime janë njoftuar secila drejtori që ka pasur ndonjë të gjetur nga Auditori, si dhe është futur në grupin punues. Sigurisht që do të njoftoheni si Kuvend lidhur me zbatimin e rekomandimeve.

Pika 8

Shqyrtimi i Kërkesave

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Lexoi kërkesat:

1. z.Bekim Sinani, përfaqësues i firmës "DONI FRUITS" Rr."Driton Islami" p.n. Ferizaj, Kërkesa Nr.01-70/05-10213/19 datë: 16.04.2019.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Pasi njoftoi Kuvendin me rekomandimet e KPF-së, si dhe të zyrtarit ligjor, hapi diskutimin për këtë kërkesë.

z.Perparim Ramusa; Kërkesën e firmës "Doni Fruits" e kemi shqyrtuar 5-6 herë. Ky ka kërkuar që pronën Komunale që ja kemi dhënë në shfrytëzim me e fut në hipotekë. Në emër të subjektit të PDK-së ne propozojmë që firmës "Doni Fruits" të ja lejojmë që pronën Komunale që ja kemi dhënë në shfrytëzim për 99 vite, me e fut në hipotekë, sepse ky ka bërë investime në Zonën Ekonomike rreth 2 milionë euro.

z.Fehmi Hysenaj; Unë sot kam kërkuar që të na silltet Kontrata e Komunës me pronarin e firmës "Doni Fruits", sepse Hipoteka nuk është punë e thjeshtë. Unë realisht nuk jam për me ja dhënë këtë të drejtë dhe do të bëj krejt që kjo mos të ndodhë. Sqarimi i MAPL-së ka qenë korrekt. Unë nuk

mendoj se kjo çështje është në Kontratë sepse po të ishte atëherë ne nuk do të diskutonim këtu. Unë ju lus që këtë mos ta bëni, sepse pastaj do të kemi edhe kërkesa të bizneseve të tjera.

z.Ruzhdi Jashari; Kjo kërkesë po na përsëritet qe disa herë. Ne kemi nevojë për korrektësi. Këtij ne po duam që të ja mundësojmë një çështje në kundërshtim me Ligjin. Unë këtë kërkesë do ta kundërshtoj. Ndërsa mostrat e Komunave të tjera që na i ka sjellë këtu Kryesuesja, absolutisht nuk kanë të bëjnë me çështjen. Ne me këtë vetëm po mundësojmë hapjen e një zinxhiri të gjatë të problemeve, sikurse që ka ndodhur për disa çështje të tjera që është dashur me i shqyrtuar nga disa herë. ky veprim është në kundërshtim me interesin e qytetarëve. Ne si 2 përfaqësues të subjektit të Vetëvendosjes jemi fuqimisht “kundër”.

z.Isak Muslija; Të them të drejtën propozimi i Përparimit është për tu habitur si deputet, qysh ka mundësi, që vendimi me u ndryshuar, ose cili është garancioni që ai e lanë borxhin e kredisë, dhe që neve pastaj Banka na e merr tokën. Këta të PDK-së e paskan vendosur me ja dhënë. Unë kërkoj nga Zyrtari Ligjor me na e shpjeguar mirë këtë çështje, sepse nashta më mirë do të ishte me ja falë tokën atij se sa me e futë në hipotekë.

z.Fehmi Hysenaj; Po dua të sqaroj diçka që ka të bëj me firmat e regjistruara si SH.P.K këto firma në rast të falimentimit përgjigjen vetëm me mjetet e themelimit. Tash këta dy pronarë kanë zero % mjete themeluese, kështu që ne po e japim pronën për hipotekë te një firmë që ka zero mjete financiare, e që nënkupton me zero përqindje siguri.

z.Naim Zejna; I kemi pa rastet në Skenderaj e Gjakovë. Është rast i veçantë te Zona Ekonomike. Unë po kërkoj që para se me vendosur ta shohim Kontratën. E dimë që investitori është serioz. Unë jam i mendimit që ta shtyjme edhe pak me qëllim që të marrim informacione edhe pak më shumë. Unë po kërkoj sqarime shtesë.

znj.Arbresha Sylja; Te kjo pjesë argumentet që u prezantuan na hedhin dyshime, por unë po i pyes kolegët deputet se çka është puna me lehtësirat për biznese. Si anëtarë të Kuvendit ne duhet të ofrojmë sa më shumë lehtësira për bizneset, kështu që ne duhet që ti shfrytëzojmë resurset e mos ti lëmë thatë. Duhet ta kemi parasysh faktin se çka do të thotë nëse një investitor tërhiqet, prandaj duhet të shikohet edhe ana tjetër që i përket largimit të investitorëve.

z.Skender Hyseni; Unë kam një pyetje, a ka marrë kredi ai najherë. Nesër ajo pronë mundet me u djegë. Kjo për mua nënkupton që dmth. që me dorën tënde me nënshkruar që nëse kjo firmë dështon, prona e Komunës është e Bankës. Pra unë konsideroj se hipoteka në këtë rast nuk është e mirë.

z.Përparim Ramusa; Unë nuk mendoj se bizneset serioze nuk mund të funksionojnë pa kredi. Ai është investitor serioz. Prandaj ju kisha lutë që ta merrni si lehtësim për bizneset.

z.Besnik Seferi; Në hipotekë futet vetëm prona e babës ose e jotja. Unë mendoj se me vendim tonin nëse aprovohet ajo pronë po tjetërsohet. Ne kemi bërë mjaft shumë lehtësira për bizneset qoftë me heqjen e taksave por edhe me vetë faktin që ja kemi dhënë pronën komunale në shfrytëzim për 99 vite. Nëse ne marrim vendim për ta futur në hipotekë atë pronë ne jemi duke bërë gabimin më të madh të mundshëm, për këtë arsye ne jemi gjithqysh “Kundër”.

z.Rexhep Gashi; Ne kemi qenë “Për” që këtij biznesi me ja dhënë në shfrytëzim pronën Komunale. U përmendën investimet që ka bërë rreth 2 milionë ky biznes, mirëpo unë e di që aty ka pas investime nga Bashkimi Evropian e që këto investime nuk janë të tij. Unë konsideroj se është punë e vështirë dhe e komplikuar që me e fut në hipotekë pronën komunale.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Propozoj që ne ta presim drejtorin derisa të na e sjellë kontratën, sepse unë e lajmërova me telefon, kështu që ne po kalojmë me kërkesën tjetër.

z.Fehmi Hysenaj; Unë po i lus kolegët e PDK-së më të rinj dhe të tjerët që paraprakisht me e pa kontratën. Ndryshe unë do të kërkoj që emri im të shënohet në proces verbal për sa i përket votës time.

z.Reshat Mujota; Unë po kërkoj që të konsultohemi edhe pak me Kryqtarët e Grupeve Parlamentare, për këtë arsye na nevojitet një pauzë.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Atëherë po jap 5minuta pauzë.

Mbledhja e Kuvendit vazhdon pas 5minutave, ku Kryesuesja konstaton Kuorumin prej 19 anëtarëve të Kuvendit prezentë në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, me 10 vota “Për” me 7 vota “Kundër” dhe me 2 vota “Abstenim” aprovoi, vendimin me të cilin i epet mundësia për ta futur në Hipotekë, Ngastrën Kadastrale Nr.1398/9, Z.K- Shtime; Me Sipërfaqe të tokës 9038m² (Nëntë mijë e tridhjetë e tetë metra katror), në Zonën Ekonomike-Shtime, Firmës “DONI FRUITS” SH.P.K. me seli në Ferizaj, me Numër të biznesit: 71103307, të cilën Kuvendi i Komunës së Shtimes ja ka dhënë në shfrytëzim për 99 vite me vendimin Npi-01/186 më datën 26.06.2015.**

“Kundër” votuan: Fehmi Hysenaj (NISMA), Isak Muslija (AAK), Ruzhdi Jashari (LVV), Besnik Seferi (LVV), Skender Hyseni (LDK), Naim Zejna (LDK), Rexhep Gashi (LB).

Në ora 13.20 minuta, e deri në fund të mbledhjes së Kuvendit, në shenjë pakënaqësie me rezultatin e votimit për këtë kërkesë, Mbledhjen e Kuvendit e kanë lëshuar: Fehmi Hysenaj, Isak Muslija, Ruzhdi Jashari, Besnik Seferi, dhe Rexhep Gashi.

2. z. Bahri Rexhaj nga fshati Petrovë, i përfaqësuar nga Avokati z. Kemajl Ademaj me zyrën e Avokatisë në Ferizaj Rr. “Hamëz Jashari” p.n. Kërkesa Nr.01-070/05-1225/20 datë: 16.01.2020.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Hapi diskutimin për këtë kërkesë.

znj. Arbresha Syla; Unë kërkoj që kjo kërkesë të aprovohet dhe kompensimi të bëhet pronë me pronë.

znj. Adelina Beqaj; Edhe unë jam që prona të kompensohet tokë me tokë.

z. Perparim Ramusa; Pajtohem me propozimin, por unë jam që pronarëve të parcelave fqinje tu mundësohet qasja e lirë në rrugë.

z. Reshat Mujota; Pajtohem edhe unë me propozimin që pronarët e tokave aty të kenë qasje në rrugë, por duhet patjetër të përmendët koha se kur të hapet rruga.

znj. Adelina Beqaj; Aty përmendët rruga, por në fakt aty është vetëm një urë lidhëse.

z. Skender Hyseni; Ne duhet me vendos në mënyrë të duhur për me e gjet një rrugë alternative. Ne nuk duhet që ti zgjerojmë konfliktet por që ti zgjidhim ato.

z. Naim Zejna; Parimisht pajtohem me propozimin e Skenderit.

znj. Zarife Rexhaj; Unë thjeshtë po kërkoj që prona të precizohet saktë.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 14 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Kuvendi Komunës së Shtimes, unanimisht aprovoi, vendimin me të cilin aprovohet kërkesa Nr.01-070/05-1225/20 datë: 16.01.2020, e z. Bahri Rexhaj nga fshati Petrovë, i përfaqësuar nga Avokati z. Kemajl Ademaj, për Këmbimin e Pronës së paluajtshme të Ngastrës Kadastrale Nr.985-2; Z.K-Petrovë, me sipërfaqe prej 699 m², si dhe pjesë të Ngastrës Kadastrale Nr.118-2; Z.K-Petrovë, me sipërfaqe prej 154 m². Totali sipërfaqeve: 853 m². Evidentuar pronë e Bahri /Shaban/ Rexhaj nga fshati Petrovë. Duke e këmbyer në sasi të barazvlefshme me pronën e paluajtshme të Komunës së Shtimes me Ngastrën Kadastrale Nr.724-0; Si dhe me pjesë të Ngastrës Kadastrale Nr.729-0; Z.K- Petrovë. Evidentuar Pasuri Shoqërore e Kuvendit Komunal – Shtime.**

3. z. Sali Beqa - Petrovë, Kërkesa Nr.01-070/05-6235/20 datë: 09.03.2020.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Hapi diskutimin për këtë kërkesë.

znj. Zarife Rexhaj; Unë desha vetëm të pyes se a ka ardhur në Sekretari të Kuvendit një kërkesë nga fshati Davidovc?

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Jo.

z. Idajet Rexhepi, Zyrtar i Kuvendit; Jo. (dha sqarim).

z.Naim Zejna; Ata (fshati Davidovc) kanë thënë se e kanë bërë një kërkesë në formë elektronike për shkak të pandemisë, dhe si të tillë ne nuk e kemi marrë. Unë propozoj që kjo kërkesë të shtyhet.

z.Herolind Selmani; Edhe ne po dakordohemi se kjo kërkesë duhet me u shty.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 14 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 13 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim” vendosi që kërkesa me numër: Nr.01-070/05-6235/20 datë:09.03.2020, e z.Sali Beqaj nga fshati Petrovë, të shtyhet për shqyrtim, deri në mbledhjen e radhës, me arsyetimin që të plotësohet me informata shtesë.**

4. z.Adem ramadani, (Kryetar i fshatit Raçak), Ankesë Nr.01-070/05-9498/20 datë:16.06.2020.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Hapi diskutimin për këtë kërkesë.

znj.Arbresha Sylja; Unë mendoj se nëse i kemi dhënë leje për shfrytëzim ne tani nuk mundemi me marrë vendim për refuzim. Nëse dikush ka kundër le të thotë. Mendoj se nuk është kompetencë e Kuvendit për me vendos.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 14 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht aprovoi vendimin për hedhjen poshtë të ankesës me numër: Nr.01-070/05-9498/20 datë:16.06.2020, të z.Adem Ramadanit, (Kryetar i fshatit Raçak) me arsyetimin se Kuvendi nuk është kompetent për të vendosur për këtë.**

5. z.Rifat Imeri – Raçak, Kërkesa Nr.01-070/05-12154/20 datë:15.07.2020.

6. z.Ymri Imeri – Raçak, Kërkesa Nr.01-070/05-12156/20 datë:15.07.2020.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Para se të hapë diskutimin për këtë kërkesë tha, meqenëse kërkesat me numër 5 dhe 6 janë me përmbajtje të njëjtë propozoj që ti votojmë në pako. Në Vazhdim hapi diskutimin për këto kërkesa.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 14 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht aprovoi vendimin për shpalljen me interes të përgjithshëm, pjesën Ngastrën Kadastrale Nr.764-2, me sipërfaqe prej 63m² (gjashhtëdhjetë e tri metra katror), në Zonën Kadastrale – Raçak, Evidentuar pronë e Rifat / Ramiz / Imeri, nga fshati Raçak.**

*** Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht aprovoi vendimin për shpalljen me interes të përgjithshëm, pjesën e Ngastrën Kadastrale Nr.761-2, me sipërfaqe prej 73m² (shtatëdhjetë e tri metra katror), në Zonën Kadastrale – Raçak, Evidentuar pronë e Ymri / Shefqet / Imeri, nga fshati Raçak.**


7. z.Gani Ademaj – Petrovë, Kërkesa Nr.01-070/05-14165/20 datë:05.08.2020.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Hapi diskutimin për këtë kërkesë. Pasi që diskutime për këtë kërkesë nuk kishte, Kryesuesja, Konstatoi Kuorumin prej 14 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht aprovoi vendimin për hedhjen poshtë të kërkesës me numër: Nr.01-070/05-14165/20, datë:16.06.2020, të z.Gani Ademaj nga fshati Petrovë. Me arsyetimin se kërkesa nuk është e kompletuar dhe nuk është adresuar nga pronari ose i autorizuari i pronës së paluajtshme.**

Pasi që diskutime tjera nuk kishte Kryesuesja mbledhjen e përfundoi në ora 13.³⁷h.

Procesmbajtësi:
Idajet Rexhepi



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj

